

**OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ /04/2026

LËNDA: PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - MALLRA

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM NË GJUHËN SHQIPE DHE ANGLEZE**

I mbajtur sot në datë 03.04.2026 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, Z. Aleksandër Pjetri, person përgjegjës, i emëruar sipas Urdhërit të Prokurimit Nr. 262/3 Prot, datë 03.04.2026 për procedurën e prokurimit me objekt: “Pajisje transformuse, Transformator Fuqie dhe Çela 40.5 kV për N.Stacione”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): Transformatorë tensioni 31172000-2. Pajisje elektrike 31681000-3.

Vlera e fondit limit: 199,897,667.84 (Njëqind e nëntëdhjetë e nëntë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë presje tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH ose **(2,080,100.60** (Dy milion e tetëdhjetë mijë e njëqind euro e gjashtëdhjetë cent EUROS) euro excluding VAT) euro pa TVSH. Kursi kembimit sipas Bankës së Shqiperisë i datës 03.04.2026 është 96.10 (nëntëdhjetë e gjashtë pikë dhjetë).

Baza ligjore për zhvillimin e procedurës

Zhvillimi i kësaj procedure të prokurimit mbështetet në dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi, si më poshtë:

- Neni 33, pika 1, shkronja “a”, i Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, i cili përcakton përdorimin e procedurës së hapur për blerjen e mallrave, shërbimeve ose punëve mbi kufirin e lartë monetar;
- Neni 40 i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, i cili rregullon zhvillimin e procedurës së hapur mbi kufirin e lartë monetar për mallra, duke garantuar transparencë, konkurrencë dhe zbatim të drejtë të parimeve të ligjit;
- Neni 3 i Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, i cili përcakton parimet bazë të prokurimit publik, si transparenca, trajtimi i barabartë, mosdiskriminimi dhe përdorimi efikas i fondeve publike.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Për argumentimin e fondit limit grupi i punes i caktuar me urdher te titullarit te Ak-se, j'u referuan studimit të tregut, në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe
- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
- d) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t'i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

2. Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

Procedura e prokurimit me objekt: “**Pajisje transformuese, Transformator Fuqie dhe Çela 40.5 kV për N.Stacione**”, ka për qëllim furnizimin e Autoritetit Kontraktor me disa pajisje të cilat përdoren si pjese rezerve per N.Stacionet elektrike te Shperndarjes dhe transformatori ne N.Stacionin Hoxhare, në funksion te veprimtarisë se punës se AK.

Referuar procedurës se prokurimit, AK vlereson se kjo procedure prokurimi nuk mund te ndahet ne Lote, pasi per arsye te tipologjise se materialeve si nga pikepamja e funksionimit dhe instalimit te tyre, kane nje natyre integruese ne raport me njera tjetren ashtu edhe me N/stacionin elektrik ku do instalohen. Krijimi i marredhenies kontraktore me disa Operatore Ekonomik mund te sjelle paperdorshmeri te perkohshme ose vonesa te shuma ne funksionimin e pajisjeve dhe materialeve te cilat mund te furnizohen nga nje tjetet Operator Ekonomik, kontraktor i nje loti tjetet.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

AK nuk mund te dispononje nje element nga mallrat objekt prokurimi ne vete dhe te prese furnizimin e mallrave te tjere, ne qofte se keto jane te ndara ne lote.

Gjithashtu, vonesat qe mund te shkaktohen nga marredhenia e me disa operatore ekonomike mund te veshtiresoje edhe nevojat e AK per ushtrimin e funksionit te saj, dhe mund te krijohen probleme me furnizimin e mallrave.

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 2 parashikohet shprehimisht se: “*Qëllimi i këtij ligji është:*

- a) të rrisë eficientën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- d) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- e) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- f) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.
2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 14, Operatorët ekonomikë, prashikohet shprehimisht se:

1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.
2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

Autoritetet ose entet kontraktore mund t'u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË**

realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t'u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

Në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", I ndryshuar Kreu XI, neni 88, është parashikuar:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.
2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.
3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Referuar sa më sipër legjislacioni i prokurimit publik njih gjithashtu të drejtën e shoqërive për t'u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Në rastin konkret, ndarja në lote e procedurës së prokurimit, do të komplikonte menaxhimin e minikontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësisë duke e komplikuar realizimin me sukses të kontratës.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, **Drejtoria e Tensionit të Lartë OSSH sh.a**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim si dhe përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024,2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës.

Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024,2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006”Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar; (lidhur me afatet e kryerjes se pagesave të caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2025), në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësisve vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2025 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim prodhuesi ose distributor të autorizuar për mallrat objekt prokurimi. *Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se paraqitet autorizim distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një dokumenti zyrtar të vlefshëm (kontratë, certifikatë, deklaratë etj). **Autorizimi i prodhuesit/distributorit duhet të jetë i perkthyer dhe noterizuar ne gjuhen Shqipe.***

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e autorizimeve të prodhuesve ose distributorëve se operatorët ekonomikë janë të autorizuar nga prodhuesi apo distributori i autorizuar është një

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.3 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalogun/ët teknik për mallrat që do të furnizojë për këtë objekt prokurimi në mënyrë që të provohet pajtueshmeria me specifikimet teknike. *Në katalog, të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme mallrat e ofertuara, si edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DT. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike, me qëllim që AK të vlerësojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në DT.*

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e katalogut/ëve është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosija e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar, si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat të cilat verifikojnë që prodhuesi është në përputhje me të gjitha normativat CE sipas standarteve: SSH EN 60947-2:2017, SSH EN 61000-6-1:2019, SSH EN 61000-6-3:2021; SSH EN 6-3-2:2019+A2 2024, SSH EN 61000-3-3:2013 dhe një deklaratë ku merr persiper se të gjithë mallrat e prodhuara për këtë procedurë prokurimi do të jenë sipas standarteve të mesiperme CE. AK do pranojë edhe mundësinë e paraqitjes së standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardit evropian dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë **SSH IEC SSH EN.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 40 pika 6 gërma (c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Në përmbushje të kriterit të mësipërm Operatorët Ekonomike, duhet të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të ngjashme për të krijuar bindjen AK se malli i ofruar është brenda parametrave të kërkuara.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë raportet e testimit (*type tests*) që verifikojnë se pajisjet si Transformator fuqie dhe Çela nenstacioni janë në përputhje me kërkesat e AK. AK

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

do pranojë edhe mundësinë e paraqitjes së standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardit europian dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë *SSH IEC SSH EN*.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 40 pika 6 gërma (c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Në përmbushje të kriterit të mësipërm Operatorët Ekonomike, duhet të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të ngjashme për ti krijuar bindjen AK se malli i ofruar është brenda parametrave të kërkuara.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, ku deklaron se të gjithë produktet janë të rinj (të papërdorur).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, me anë të këtyre deklaratave AK krijon bindjen se operatori ekonomik do të përmbush kontratën bazuar në specifikimet dhe kërkesat teknike të kërkuara nga AK, duke garantuar furnizimin me mallra të reja.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 9001 ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit të prodhuesit/distributorit ekuivalentet e tyre: Kjo certificate kerkohet ne momentin e levrimin te mallit nga operatori ekonomik fitues dhe shoqeron mallin qe instalohet ne objekt. Kurse ne momentin e ofertimit AK pranon mundësinë të një vetëdeklarimi nga OE ofertues që në këtë rast, furnizuesi është konform standardeve të cilësisë dhe rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit.

a) ISO 9001 – “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;

Argumentimi: Kërkesa në lidhje me këto çertifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

Eshte kerkuar ky kriter per inxhinier elektrik te certifikuar per kete proces pune, sepse transformatori i fuqise ekzistues qe do te zevendesohet nga i riu, ka te instaluar dhe monitoron dhe analizon sasine e gazrave qe ky transformator cliron gjate punes.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të plotësojë saktësisht kolonën e emërtuar “Të dhëna teknike të ofruara nga ofertuesi” në të gjitha tabelat e paraqitura në shtojcën (Specifikimet teknike) të këtyre DT-ve.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Argumentimi: Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij ose me kontratë shërbimi, për periudhën 3 muajt e fundit duke marrë referencë datën e publikimit të tenderit, minimalisht 1 (një) inxhinier elektrik i certifikuar nga prodhuesi ose ekuivalentet e këtyre certifikimeve, i transformatorit te fuqise per: instalim, testim, vendeje ne operim (energjezim).

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaratimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaratimit si:

Kontraten e punes

Diplomën e inxhinierëve;

Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën tre muajt e fundit.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. Drejtoria e Tensionit te Larte OSSH sha, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.Kriteri i mësipërm lidhet ngushtësisht me Specifikimet teknike për objektin e kërkuar.

Duke qene se transformatori i fuqise eshte nje pajisje shume komplekse, teper delikate ne instalim, me rendesi te vecante per N.Stacionin elektrik dhe me nje kosto te larte, AK ka kerkuar qe OE i cili do te shpallet fitues duhet te kete ne stafin e tij minimalisht nje inxhinier elektrik i certifikuar nga prodhuesi i transformatorit te ofertuar per instalim, testim dhe vendosje ne operim. Kjo kerkese teknik behet qe AK te zvogeloje rrezikun e deshtimit te vendosjes ne pune te transformatorit gjate instalimit ne objekt (N.Stacioni Hoxhare) dhe mbajtjen e garancise nga fabrika, pasi koha e riparimit te demtimeve gjate instalimit eshte e barabarte ose me e larte se koha e prodhimit + transportit te transformatorit per here te pare. Kjo vendos perpara nje situate

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

aspak te mire AK pasi rrezikohet qe N.Stacioni Hoxhare te ngelet pa transformator per nje kohe te gjate. Kjo kerkese siguron AK qe OE i cili do te shpallet fitues ka ne stafin e tij inxhinier me eksperience te meparshme ne instalimin, testimin dhe vendosjen ne pune te transformatoreve te fuqise. AK vlereson se ky kriter eshte ne perputhje me parashikimin e nenit 77, pika 1, te LPP-se si dhe te nenit 40, VKM Nr. 285, date 19.05.2021. Duhet te kemi parasy se keto certifikime nuk jepen nga autoritete ekuivalente por nga prodhuesi, ketu nuk kemi te bejme ne diskriminim pasi cdo prodhues transformatori mund te trajnoje ne fabrikat e tij inxhinier te OE-ve qe ka bashkepunim per te kryer proceset: instalim, testim, vendosje ne pune.

Lidhur me kerkesen e mesiperme, per minimalisht 1 (nje) inxhinier elektrik i certifikuar nga prodhuesi i transformatorit te fuqise, eshte rendesishem per arsyet e mesposhtme:

1. Operatori ekonomik duke montuar, instaluar dhe vendosur ne pune transformatorin e fuqise te furnizuar dhe te kerkuar, nepermjet specialistit inxhinier elektrik te certifikuar nga prodhuesi i transformatorit, sigurohet qe montimi, instalimi, kolaudimi, testimet e nevojshme, dhe ne fund energjizimi I pajisjes, jane kryer sipas kushteve dhe kriterëve te prodhuesit, dhe garancia e pajisjes per periudhen 24 mujore te kerkuar nga AK, eshte pergjegjesi e Operatorit Ekonomik, duke qene se te gjitha punimet e venies ne pune jane kryer nga ai.
2. Inxhinieri elektrik i certifikuara nga prodhuesi, realizon, kontrollon punimet nga momenti i mberritjes ne N.Stacion deri ne venien ne pune te plote te tij si me poshte:
 - Montim dhe Instalimi.
 - Montimi, pozicionimi i duhur i transformatorit mbi bazament.
 - Verifikimi I te gjitha lidhjeve mekanike elektrike sipas fabrikes prodhuese.
 - Lidhja me rrjetin ekzistues 110, 35 dhe 20kV.
 - Energjizimi.
 - Kontrolli matja e rezistences se izolimit, rezistences se peshjtellave para energjizimit, kontrolli ii nivelit te vajit, funksionimi i Tap Changer sipas shkalleve te ndryshimit te nivelit te tensionit 110kV, AVR rregullatorit Automatit te Tensionit etj.
 - Lidhja me pajisjet e mbrotjes se transformatorit te fuqise.
 - Energjizim gradual I transformatorit sipas proceduareve dhe protokolleve te prdhuesit.
 - Testimet

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

- Testet rutine, raporti I tensioneve TL/TM, izolimi testet dielektrike dhe ato funksionale.
- Funksionimi dhe monitorimi i sistemit te mbrojtjes, sistemit te ftohjes ONAF, etj.
- Pepruthshmeria e testeve me standartet IEC dhe SSH te kerkuara per transformatorin e fuqise.
- Prova e venes ne pune 72 ore.
 - Energjizohet transformatori dhe aplikohet tensioni dhe ngarkesa nominale per 72 ore, duke patur ne kontroll dhe monitorim parametrat kryesore te tij, funksionimi i te gjithe pajisjeve dhe elementeve perberes.
 - Rregjistrim dhe monitorim i parametrave te punes, ne intervale kohe te rregullta.
 - Kontroll i nivelit te zhurmave, vibrimeve, rrjedhje vaji etj.
- Marrja ne dorezim e pajisjes.
 - Trajnohet stafi operativ I N.Stacionit me pajisjen e re.
 - Zbatimi i rregullores se mirembatjes, shfrytezimit nga stafi operativ sipas Udhezimeve nga prodhuesi.
 - Miratimi perfundimtar dhe marrja ne dorezim.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij ose me kontratë shërbimi, për periudhën 3 muajt e fundit duke marrë referencë datën e publikimit të tenderit, minimalisht 1 (një) inxhinier elektrik i çertifikuar nga prodhuesi ose ekuivalentet e këtyre certifikimeve, i transformatorit te fuqise per: instalim, testim, vendoje ne operim (energjezim).

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

- Kontraten e punes
- Diplomën e inxhinierëve;
- Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën tre muajt e fundit.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklaramit sipas shtojcës Nr. 9.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentim: Duke qene se transformatori i fuqise eshte nje pajisje shume komplekse, teper delikate ne instalim, me rendesi te vecante per N.Stacionin elektrik dhe me nje kosto te larte, AK ka kerkuar qe OE i cili do te shpallet fitues duhet te kete ne stafin e tij minimalisht nje inxhinier elektrik i **certifikuar nga prodhuesi i transformatorit te ofertuar** per instalim, testim dhe vendosje ne operim. Kjo kerkese teknik behet qe AK te zvogeloje rrezikun e deshtimit te vendosjes ne pune te transformatorit gjate instalimit ne objekt (N.Stacioni Hoxhare) dhe mbajtjen e garancise nga fabrika, pasi koha e riparimit te demtimeve gjate instalimit eshte e barabarte ose me e larte se koha e prodhimit + transportit te transformatorit per here te pare. Kjo vendos perpara nje suate aspak te mire AK pasi rrezikohet qe N.Stacioni Hoxhare te ngelet pa transformator per nje kohe te gjate. Kjo kerkese siguron AK qe OE i cili do te shpallet fitues ka ne stafin e tij inxhinier me eksperience te meparshme ne instalimin, testimin dhe vendosjen ne pune te transformatoreve te fuqise. AK vlereson se ky kriter eshte ne perputhje me parashikimin e nenit 77, pika 1, te LPP-se si dhe te nenit 40, VKM Nr. 285, date 19.05.2021. Duhet te kemi parasy se keto certifikime nuk jepen nga autoritete ekuivalente por nga prodhuesi, ketu nuk kemi te bejme ne diskriminim pasi cdo prodhues transformatori mund te trajnoje ne fabrikat e tij inxhinier te OE-ve qe ka bashkepunim per te kryer proceset: instalim, testim, vendosje ne pune.

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij ose me kontratë shërbimi, për periudhën 3 muajt e fundit duke marrë referencë datën e publikimit të tenderit, një minimum punonjësish të çertifikuar për:

2 (dy) specialist/ inxhinier elektrik të çertifikuar për sigurinë teknike në punë ndaj elektricitetit (dëshmi kualifikimi i sigurimit teknik nga **OMVK ose nga institucione ekuivalente me të**).

2 (dy) teknik elektrik të çertifikuar për sigurinë teknike në punë ndaj elektricitetit (dëshmi kualifikimi i sigurimit teknik nga **OMVK ose nga institucione ekuivalente me të**).

1 (nje) specialist/ inxhinier ndertimi i çertifikuar për sigurinë teknike në punë ndaj elektricitetit (dëshmi kualifikimi i sigurimit teknik nga **OMVK ose nga institucione ekuivalente me të**).

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

- Kontraten e punes
- Çertifikatat përkatëse;
- Diplomën e inxhinierëve;
- Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën tre muajt e fundit nga shpallja e tenderit.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Lidhur me kërkesen e mesiperme, për 2 (dy) specialist / inxhinier elektrik dhe 2 (dy) teknik elektrik të certifikuar për sigurinë teknike në punë ndaj elektricitetit (dëshmi kualifikimi i sigurimit teknik nga OMVK ose nga institucione ekuivalente me të) është e nevojshme, sepse procedura që përfshihet me lart për montimin, instalimin, testimin, vënien në punë energjizimin, dhe përfundimi i provës 72 orëshe,

- Është një procedurë e gjatë në kohë.
- Është e nevojshme për bashkëpunimin dhe komunikimin me njëri tjetrin në kohën e kryerjes së këtyre procedurave, por që janë në proces remote dhe local, në distancë njëri në sallën e kontrollit dhe tjetri në pajisje për kryerjen e veprimeve manuale dhe ato automatike.

Lidhur me kërkesen e mesiperme, 1 (një) specialist/ inxhinier ndërtimi i certifikuar për sigurinë teknike në punë ndaj elektricitetit (dëshmi kualifikimi i sigurimit teknik nga OMVK ose nga institucione ekuivalente me të), nevojitet për projektimin dhe zbatimin e punimeve civile (portali i transformatorit të fuqisë dhe bazamenti për portalin e transformatorit të fuqisë).

2.3.12 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të provojë se disponon pajisjet në pronësi ose me kontratë qeraje, me afat kohezgjatje për të gjithë kohën e vazhdimësisë së kontratës, pajisjet për instalimin e transformatorit të fuqisë si më poshtë:

1. Makineri për trajtimin e vajit me kapacitet 9000 L/H me tregues për prezencën e H₂O në vaj.
2. Kenotron për testimin e izolacionit të shpimit të vajit deri në 100kV.
3. Testues i lageshtirës dhe nivelit të H₂ në vaj.
4. Mikro ohm meter 100 A me certifikatë kalibrimi.
5. Terra ohm meter 10kV me certifikatë kalibrimi.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

6. Analizator peshtjellash, koeficient transformimi, grup lidhje, rezistence ohmike e peshtjellave me certifikate kalibrimi.
7. Testues per rregullatorin e tensionin nen ngarkese (OLTC) me certifikate kalibrimi.
8. Testues per kurben e pergjigjes nga frekuenca te peshtjelles (SFRA) me certifikate kalibrimi.
9. Auto-vinç min. 100 ton.

Pajisjet duhet te jete i pajisur me dokumentacion perkates sipas legjislacionit ne fuqi.

Per te permbushur kriteret e mesiperme ne fazen e ofertimit, operatori ekonomik duhet deklaroje disponimin e makinave ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, sipas shtojces perkatese te DST.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentim: Lidhur me kerkesen e mesiperme per pajisjet e disponueshme, jane te nevojshme per kryerjen e te gjitha procedurave te sipercituara, realizimin dhe venien ne pune, ne kohen e nevojshme me te shkurter te mundur, dhe duke qene se zevendesohet nje pajisje qe eshte ne pune. Pershkrimi i punes, procesit te kryer nga seicila makineri pershkruhet shkurtimisht me poshte:

1. Makineria per trajtimin e vajit me kapacitet 9000L/H

- Përdoret për filtrimin, degazimin dhe tharjen e vajit izolues të transformatorit gjatë montimit.
- Hiqen lagështira, gazrat e tretur dhe papastërtitë që ndikojnë në forcën dielektrike të vajit.
- Treguesi i H₂O siguron kontroll të vazhdueshëm për të shmangur prishje të izolimit.

2. Kenotron për testimin e izolacionit të vajit (deri 100 kV)

- Shërben për të matur tensionin e shpimit (dielectric breakdown voltage) të vajit.
- Siguron që vaji i mbushjes së transformatorit ka veti izolante të mjaftueshme përpara se transformatori të vihet në punë.

3. Testues i lagështirës dhe nivelit të H₂ në vaj

- Analizon praninë e ujit dhe hidrogjenit të tretur në vaj.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

- Hidrogjeni është tregues i hershëm i defekteve të brendshme (si shkëndija ose mbinxehja).
- Siguron që transformatori është i pastër dhe i shëndetshëm përpara energjizimit.

4. Mikro-ohm metër 100 A

- Përdoret për të matur rezistencën e kontaktit në lidhjet e fuqisë (busbarë, terminale, ndërprerës, nyje).
- Zbulon lidhje të dobëta ose të papastra, të cilat mund të shkaktojnë mbinxehje gjatë punës.

5. Terra ohm meter 10 kV

- Teston rezistencën e izolimit ndërmjet pështjellave dhe tokëzimit.
- Siguron që izolimi i transformatorit dhe aksesorëve të tij (kabllo, izolatorë) është brenda vlerave të pranueshme për tensionin e punës.

6. Analizator i pështjellave (koeficient transformimi, grup lidhje, rezistencë ohmike)

- Kontrollon raportin e transformimit që duhet të përputhet me projektin.
- Verifikon grupin e lidhjes së pështjellave sipas kërkesave të rrjetit.
- Mat rezistencën e pështjellave, duke zbuluar anomali si qark i shkurtër në spirale ose lidhje jo të barabarta.

7. Testues për rregullatorin e tensionin nën ngarkesë (OLTC) me certifikatë kalibrimi.

- Kontrollon funksionimin e rregullatorit të tensionit OLTC përpara energjizimit të transformatorit për të siguruar që nuk ka asnjë problem gjatë energjizimit.
- Teston koeficientin e transformimit për çdo shkallë të OLTC

8. Testues për kurben e përgjigjes nga frekuenca të pështjelles (SFRA) me certifikatë kalibrimi.

- Kontrollon formën gjeometrike të pështjellave të transformatorit të fuqisë, për të bërë krahasim me testimin SFRA në fabrikë nëse pështjellat kanë marrë deformime fizike gjatë procesit të transportit dhe pozicionimit në pozicionin final.

9. Auto-vinç min. 100 ton

- Përdoret për shkarkimin, vendosjen dhe montimin fizik të transformatorit të fuqisë dhe pjesëve të tij (transformatorin, radiatorët, pjeste perberese etj).

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

- Siguron që procesi të bëhet me siguri, pa dëmtuar transformatorin që është pajisje e rëndë dhe delikate.

Me këto pajisje, bëhen testet e pranimit në vend (site acceptance tests – SAT), si dhe sigurohet që transformatori është i pastër, i thatë, i lidhur siç duhet dhe i sigurt për energjizim.

Lidhur me kërkesen e mesiperme për pajisjet e disponueshme, janë të nevojshme për kryerjen e të gjitha procedurave të sipercituara, realizimin dhe venien në punë, në kohën e nevojshme me të shkurter të mundur, dhe duke qenë se zëvendësohet një pajisje që është në punë.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin...

Përsa më sipër, ofertuesi i kualifikuar, i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin, e parashikuar në pikën 6, të nenit 26, të Rr.P.P., brenda afatit 5 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1, të LPP-së.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të brendshme DTL/ Grup pune pranë Autoritetit Kontraktor Përfitues DTL, për objektin që prokurohet, të ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, përlllogaritje fondi dhe kriteret të vecanta kualifikuese në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të mallrave objekt prokurimi autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

SUBJECT: MINUTES – TYPE OF CONTRACT – GOODS

FOR THE JUSTIFICATION AND APPROVAL OF TECHNICAL SPECIFICATIONS AND QUALIFICATION CRITERIA IN ALBANIAN AND ENGLISH

Held today on 03.04.2026 by the members of the Procurement Unit, Mr. Aleksandër Pjetri, Ms. Stela Koçi, and Mr. Rezart Sulaj, responsible persons appointed under Procurement Order No. 262/3 Prot., dated 03.04.2026, for the procurement procedure with the subject: “Transformer Equipment, Power Transformer, and 40.5 kV Switchgear for Substations.”

Relevant codes in the Common Procurement Vocabulary (CPV): Voltage transformers (CPV code 31172000-2); Electrical equipment 31681000-3.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Estimated contract value: 199,897,667.84 (one hundred ninety-nine million eight hundred ninety-seven thousand six hundred sixty-seven point eighty-four) Albanian lek excluding VAT, or **2,080,100.60** (two million eighty thousand one hundred point sixty) euros excluding VAT.

The exchange rate according to the Bank of Albania as of 03.04.2026 is 96.10 (ninety-six point ten).

For the justification of the estimated contract value, the working group appointed by order of the Head of the Contracting Authority referred to a market study, in accordance with the provisions of Council of Ministers Decision No. 285, dated 19.05.2021 “On the Approval of Public Procurement Rules,” as amended.

In calculating the estimated contract value, the contracting authority/entity must refer to one or more of the alternatives listed below:

- a) prices published by the Institute of Statistics (INSTAT), and/or other official prices recognized by relevant institutions (such as tax or customs authorities, chambers of commerce, manuals, etc.); or/and
- b) market study, based on the average of prices obtained from such study; or/and
- c) prices of previous contracts carried out by the contracting authority itself or by other contracting authorities; or/and
- d) publicly announced international prices.

The contracting authority/entity may refer to one or more of the above alternatives in calculating the estimated contract value, in order to ensure that it reflects a realistic market value and, at the same time, enables the participation of as many economic operators as possible.

2. The contracting authority/entity, prior to issuing the procurement order, must justify and document the calculation of the contract value, based on the technical specifications of the object being procured.

Justification regarding Article 39 of Law No. 162, dated 23.12.2020 “On Public Procurement,” as amended, for not dividing the procurement procedure into lots:

The procurement procedure with the subject: “Transformer equipment, Power Transformer and 40.5 kV Switchgear for Substations” aims to supply the Contracting Authority with several pieces of equipment used as spare parts for Distribution Substations and for the transformer at the Hoxharë Substation, in support of the operational activities of the Contracting Authority.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

